



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1076/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Visar Sadiku kandidat për anëtar të Asambles Komunale nga rradhët e Koalicionit Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDD) në Vushtri, paraqitur kundër Qendrës së Numrimit të Rezultateve (QNR), për shkak të publikimit të rezultateve perfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Visar Sadiku kandidat për anëtar të Asambles Komunale nga rradhët e Koalicionit AAK- LDD dega Vushtri.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Visar Sadiku kandidat për anëtar të Asambles Komunale në Zgjedhjet Lokale në Komunën e Vushtrisë, i cili pretendon që të verifikohet procesi i numërimit në këto Qendra të Votimeve : QV-2728B/01Q, QV-2710B/02R, 03R, 2711B/01R, 02R ,QV-2702B/03R në cilësinë e deshmitarit ka propozuar Egzon Gecin.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nuk janë ofruar prova për parregullsinë e pretenduar për të vërtetuar shkëlqen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1076/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj ketij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme te Republikës se Kosoves Brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i.